REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Nr.2848 Prot. **Has, me 15 / 08 /2025**

NJOFIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Titulli i Projekt Aktit : **Plani i Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Has**

Njoftim për Dëgjesë Publike

Bashkia Has, në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", si dhe të udhëzimeve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, njofton të gjithë banorët e njësive administrative, përfaqësuesit e komunitetit, fermerët, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjitha palët e interesuara, se:

Data: 08 Shtator 2025

Ora: 12.00

Vendi: Salla e Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak - Bashkia Has

do të zhvillohet Dëgjesa Publike për prezantimin dhe diskutimin e Planit të Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Has (i perditesuar)
Qëllimi i dëgjesës është:
- Të prezantohet drafti i planit të menaxhimit të pyjeve;
- Të informohet komuniteti mbi masat, prioritetet dhe investimet e parashikuara;
- Të mblidhen sugjerime, komente dhe propozime nga publiku, të cilat do të merren në konsideratë para miratimit përfundimtar të planit.

◆ Plani i Menaxhimit të Pyjeve është një dokument strategjik që synon:
- Ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të fondit pyjor të Bashkisë Has;
- Mbështetjen e ekonomisë lokale përmes shfrytëzimit të përgjegjshëm të pyjeve;
- Mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe ekosistemeve pyjore;

- Përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.

Dokumenti i plotë i planit është i aksesueshëm pranë Bashkisë Has dhe në faqen zyrtare të internetit te bashkise Has

✎ Të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit ftohen të marrin pjesë aktivisht, duke dhënë mendime e sugjerime për menaxhimin më të mirë të pasurisë sonë të përbashkët – pyjeve.

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni në adresën zyrtare të Bashkisë Has:

✉ Email:info@bashkiahas.gov.al

Tel : Nr kontakti : 0693579636

KRYETARI KESHILLIT BASHKIAK

Isuf Sefolli

